



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 9.12.2024, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Berat Lahu (LVV), Edmond Azemi (LVV), Arbnora Ajeti (PDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Feim Osmani (LVV), Ermal Osmani (LVV), Violeta Salihu (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Agron Canolli (PDK), Granit Geci (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK) dhe Liridon Selmani (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama - kryetar, Alban Zogaj - nënkryetar, Arbër Sadiku - drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Donika Çetta - drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Valbona Vitia - drejtore e Drejtorisë së Administratës, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Sibel Halimi - drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Doruntinë Maloku - drejtore e Drejtorisë së Pronës, Adelina Sahiti - drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Donjeta Dragusha - drejtore e Drejtorisë së Bujqësisë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të medieeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues i Kuvendit. **Kryesuesi** tha se për këtë mbledhje është paraparë ky:

Faqe 1 nga 3

Rend dite

1. Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025;
2. Propozim-vendimi mbi iniciimin e revidimit të Planit të hollësishëm “Zona Ekonomike” në Prishtinë;
3. Propozim-vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit zhvillimor komunal 2024-2032;
4. Propozim-vendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm “Mati 1”, Blloku A11, Prishtinë;
5. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe objektin e kultit – xhamia në fshatin Orloviq (Shkabaj), Prishtinë.

Pika e parë

Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025.

Për këtë pikë të rendit të ditës, **Kryesuesi** hapi diskutimin.

Jeta Rafuna:- tha se, si grup i asamblistëve të LDK-së e përkrahim buxhetin për vitin 2025, se është themeli i të gjitha projekteve për vitin 2025 dhe është projekti më i madh, buxheti më i madh që ka ndodhur ndonjëherë në Komunën e Prishtinës.

Endrit Gashi: - tha se, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përkrahë këtë vendim për miratimin e buxhetit.

Sami Boroci:- tha se edhe ne jemi pro votimit të buxhetit, por më gëzon fakti që sot po shihet si mundësi e mirë me kaluar buxheti dhe me vazhduar me projektet në Prishtinë dhe me u zhbllokuar kjo situatë.

Endrit Zabërgja: tha se, pa dyshim që edhe ne e përkrahim buxhetin për Kryeqytetin, pasi që edhe konsiderojmë se jemi të vonuar në këtë aspekt duke e kaluar kështu përgjegjësinë nga asambleja tek ekzekutivi për t’i përfunduar projektet, të cilat kryetari Rama i ka planifikuar.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025.

Pika e dytë

Propozim-vendimi mbi iniciimin e revidimit të Planit të hollësishëm “Zona Ekonomike” në Prishtinë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurta i informoi Arbër Sadiku, drejtor.

Gëzim Mehmeti: - tha se ky plan i hollësishëm është i mangët bazuar në rrethanat që gjendet Komuna e Prishtinës, kështu që mendoj që zona industriale është zona me të vërtetë ekonomike e qytetit të Prishtinës e cila i përket Planit të Kalabrisë dhe nuk është marrë parasysh, nuk është trajtuar siç duhet kjo zonë. Duke pasur parasysh këtë gjendje të kësaj zone, propozoi që kjo pjesë e revidimit të planit të zonës ekonomike, planit rregullues në realitet të bëhet zgjerimi i kufijve, bazuar në procedurat dhe në ligjet e Kosovës dhe kisha kërkuar që të shqyrtohet edhe njëherë ky revidim i këtij plani.

Arbër Sadiki, drejtor: - tha se duke pasur parasysh gjendjen momentale të kësaj zone, para se ne ta votojmë këtë propozim - plan, duhet t'i përcaktojmë kufijtë e saktë që për të cilët në qoftë se kemi ndryshime, atëherë duhet të kemi një pauzë të shkurtë dhe të kemi mundësi që teknikisht me i vendos ata kufij deri ku shtrihet ky plan.

Jeta Rafuna: - tha se për t'i ndryshuar kufijtë e këtij plani, propozoi që ta bëjmë një pauzë, të konsultohemi e që më pas të diskutojmë dhe votojmë.

Kryesuesi propozoi një pauzë prej 30 minutash.

Pas një pauze prej 40 minutave, me të filluar vazhdimi i mbledhjes, në mungesë të kuorumit, kryesuesi mbledhjen e konstatoi të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina

